

Vendim nr. 31, datë 11.03.2026

(V-31/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datat 05.02.2026 dhe 23.02.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 9 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQATA “ASOCIACIONI I GAZETARËVE TË SHQIPËRISË”**, përfaqësuar nga kryetari Isa Myzyraj dhe avokati Franc Terihati, me autorizim.

QENDRA “RRJETI BALLKANIK PËR GAZETARINË INVESTIGATIVE, SHQIPËRI - BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK, ALBANIA”, përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive Kristina Voko dhe avokati Franc Terihati, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj dhe Irma Qosja, me autorizim.

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE, në mungesë.

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.**

Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok””.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 22, 23, 45, 131, pika 1, shkronja “c”, si dhe 134, pika 1, shkronja “h” dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 45, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueseve, shoqatës “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë” dhe qendrës “Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative, Shqipëri - Balkan Investigative Reporting Network, Albania” (*Qendra BIRN Albania*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës; prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës; prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (*AKSK*) dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (*AKSHI*), të cilat mbështesin qëndrimin e Këshillit të Ministrave; mendimin me shkrim të Avokatit të Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, duke u mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës, në nenet 10, pika 1, 26, pika 1, 139, pika 2, 174 e 177, pika 5, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 32, pika 4, 32/1, 42 e 46 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat

audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 27, pika 4, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ka miratuar vendimin nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok”” (VKM-ja nr. 151/2025). Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 07.03.2025 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit në këtë fletore.

2. VKM-ja nr. 151/2025 ka parashikuar ndërprerjen e aksesit në platformën *on-line* “TikTok” në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat deri në 12 muaj, me qëllim shmangien e ndikimeve negative dhe të problematikave sociale në tërësi, kryesisht të lidhura me nxitjen e dhunës, veçanërisht te fëmijët, që sjellin probleme të zhvillimit psiko-social të tyre, si dhe garantimin e mbrojtjes të të dhënave personale (*pika 1*). Ndërprerja e aksesit në këtë platformë zgjat deri në mundësimin, nga ofruesi i platformës, të instrumenteve teknike që rregullojnë aksesin e fëmijëve në këtë platformë dhe në materiale të dëmshme për ta (*pika 2*). Në vijim, VKM-ja ka caktuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, së bashku me autoritetet rregullatore sektoriale, për të komunikuar dhe negociuar me përfaqësuesit e platformës dhe me përfaqësues të platformave të tjera *on-line*, për të adresuar problematikën në fushën e sigurisë publike dhe sociale në mjedisin digjital, duke përfshirë: a) operimin efektiv të sistemeve funksionale të verifikimit të moshës së përdoruesve të platformës; b) operimin e sistemeve të kontrollit prindëror lidhur me përmbajtjet që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijëve; c) shmangien e publikimit të materialeve me përmbajtje dhune, bullizmi, gjuhë urrejtjeje apo me fjalor të papërshtatshëm; ç) përshtatjen dhe përdorimin e filtrave të moderimit për gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare (*pika 3*).

3. Kjo VKM ka parashikuar gjithashtu detyrimin e AKSK-së, në bashkëpunim me entet rregullatore të fushës, për të marrë masat e nevojshme për realizimin e ndërprerjes së aksesit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi (*pika 4*) dhe, pasi të realizohet nga platforma vendosja e filtrave të nevojshëm, mund të vendosen masa të reja ose të rishikohen masat në fuqi (*pika 5*). Në përfundim, janë ngarkuar Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, AKSK-ja, AKSHI-ja dhe autoritetet rregullatore sektoriale për zbatimin e këtij vendimi (*pika 6*).

4. Shoqata “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë”, Qendra BIRN Albania dhe Qendra

“Centre for Legal Empowerment” (*Qendra CLE*) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) fillimisht në datën 19.03.2025, me kërkesë sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 01.04.2025.

5. Në datën 25.04.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Me vendimin e datës 02.05.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur ndarjen e çështjes dhe shqyrtimin veçmas të kërkesës së Qendrës CLE, si dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike për kërkeset e tjera, thirrjen e subjekteve të interesuara dhe marrjen e mendimit me shkrim të Avokatit të Popullit. Me vendimin e po kësaj date, Mbledhja e Gjyqtarëve, me shumicë votash, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 151/2025, me argumentin se në rastin konkret nuk plotësohen kërkesat e nenit 45 të Ligjit Organik të Gjykatës, si për sa i takon pariparueshmërisë së pasojave të pretenduara në të drejtat kushtetuese ose interesat e ligjshëm, ashtu edhe për sa i përket urgjencës së ndërhyrjes.¹

6. Për sa i përket kërkesës së Qendrës CLE, me vendimin nr. 113, datë 02.05.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se kjo qendër nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues të VKM-së nr. 151/2025, për sa kohë ajo nuk arriti të provonte konkretisht cenimin e veprimtarisë së saj nga ky akt.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. *Kërkeset*, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se:

7.1. *Për juridiksionin e Gjykatës*

Gjykata ka juridiksion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, pasi VKM-ja nr. 151/2025 zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe u drejtohet të gjithë përdoruesve të platformës *on-line* “TikTok”, si atyre aktualë, ashtu edhe atyre potencialë, pra një kategorie të papërcaktuar nominalisht, por të

¹ Kryetarja Fiona Papajorgji votoi për shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 151/2025 në seancën plenare ndërsa gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja votuan për pranimin e kërkesës për pezullim.

konsideruar në mënyrë abstrakte dhe në tërësinë e saj. Ajo ka vendosur ndërprerjen e aksesit për të gjithë përdoruesit aktualë ose potencialë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar kështu rregulla të përgjithshme me karakter normativ, si dhe efektet e saj shtrihen në mënyrë të vazhdueshme ndaj subjekteve të papërcaktuara të së drejtës.

7.2. Për legjitimimin e kërkueseve

Kërkueset legjitimohen *ratione personae*, pasi janë regjistruar si persona juridikë në gjykatë dhe gëzojnë personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Po kështu, ato legjitimohen edhe *ratione materiae*, pasi VKM-ja e kundërshtuar ka prekur interesa të drejtpërdrejtë të tyre dhe objektin e veprimtarisë së tyre, të parashikuar në statut, si dhe cenon të drejtat dhe liritë që kërkueset synojnë të mbrojnë. Gjithashtu, VKM-ja ka cenuar mënyrën e ushtrimit të profesionit të gazetarëve dhe funksionimin e medias, nga njëra anë, dhe të drejtën e individëve për t'u shprehur lirisht, nga ana tjetër, çka provon lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet objektit të organizatave dhe fushës së rregulluar nga akti normativ. Kërkueset legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar.

7.3. Për themelin e çështjes:

7.3.1. VKM-ja nr. 151/2025 cenon:

7.3.1.1. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të parashikuar në nenin 11, pika 3, të Kushtetutës, pasi ndërprerja e aksesit në platformën “TikTok” ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta në ushtrimin e veprimtarive ekonomike të lidhura me përdorimin e kësaj platforme. Ajo përdoret nga shumë gazetarë për të shpërndarë lajme, për të realizuar reportazhe të shkurtra e për të angazhuar qytetarët në një debat publik të hapur dhe kufizimi i aksesit në këtë platformë u kufizon atyre burimet financiare. Mbyllja e platformës sjell humbje të konsiderueshme financiare edhe për bizneset, pasi u kufizon mundësinë për të arritur audiencën pa pagesa të konsiderueshme reklamash në mediat tradicionale, duke dëmtuar sektorët e teknologjisë, turizmit dhe artizanatit. Po ashtu, masa ka pasoja edhe në industrinë e muzikës, duke

ndikuar negativisht në zhvillimin e saj dhe në të ardhurat e profesionistëve të përfshirë në këtë sektor. Gjithashtu, mbyllja e platformës shkakton rënie të ndjeshme të ekspozimit për destinacionet turistike më pak të njohura, kufizon mundësitë për promovim pa kosto për operatorët turistikë dhe ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e të ardhurave për bizneset që varen nga promovimi në këtë platformë *on-line*, sikundër edhe në industrinë e ushqimit dhe të restoranteve. Çdo akt që kufizon në mënyrë arbitrare përdorimin e platformave digjitale, qasjen në informacion ose ofrimin e shërbimeve të nevojshme përbën jo vetëm devijim nga politikat publike, por edhe ndërhyrje të drejtpërdrejtë në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Në këtë drejtim, platforma “TikTok” mbetet një mjet i rëndësishëm që mundëson gjenerimin e të ardhurave, ndaj gjykimi kushtetues nuk duhet të bëhet vetëm në nivel numerik.

7.3.1.2. *Lirinë e shprehjes, të shtypit dhe të drejtën për informim*, pasi kufizon në mënyrë të përgjithshme dhe të pakushtëzuar aksesin e qytetarëve, gazetarëve dhe bizneseve në një nga hapësirat kryesore dhe më gjithëpërfshirëse të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit në epokën digjitale. Për gazetarët dhe organizatat e medias ndalimi i një platforme të tillë do të thotë humbje të një kanali të rëndësishëm për të shpërndarë lajme, për të komunikuar me audiencën dhe për të nxitur debatin publik. Gjithashtu, qytetarëve u kufizohet aksesin në informacionin që shpërndahet përmes kësaj platforme.

7.3.1.3. *Parimin e shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi situata e përdoruesve të platformës rëndohet ndjeshëm deri në cenimin në thelb të të drejtave dhe lirive të tyre, veçanërisht të atyre që e përdorin platformën për qëllime ekonomike, informuese dhe profesionale. VKM-ja nuk ka parashikuar asnjë periudhë tranzicioni, duke i lënë përdoruesit e platformës në një gjendje paqartësie dhe pamundësie efektive për të përshtatur aktivitetet e tyre në mënyrë të rregullt dhe pa pasoja kaq të rënda, duke ndikuar te bizneset, mediat dhe qytetarët. Për bizneset ajo krijon një

problem serioz të paqëndrueshmërisë ekonomike dhe pasojave financiare, duke i lënë në një situatë pasigurie për të ardhmen ekonomike dhe profesionale. Po kështu, ndalimi i platformës ka rezultuar në humbjen e të dhënave të akumuluarra ndër vite, pa një mekanizëm mbrojtës ose kompensues. Për sa i përket medias, mbyllja e platformës dëmton procesin e ndërtimit të audiencës dhe angazhimit me publikun, pasi nuk është dhënë kohë e mjaftueshme për krijimin e kanaleve alternative të shpërndarjes së përmbajtjes dhe komunikimit me ndjekësit.

7.3.2. Masa e marrë me VKM-në nr. 151/2025 nuk përmbush kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave, sipas nenit 17 të Kushtetutës, pasi:

7.3.2.1. Për sa i përket kriterit “vetëm me ligj”, asnjë dispozitë e ligjeve, mbi bazën e të cilëve ka dalë VKM-ja, nuk urdhëron nxjerrjen e një akti të tillë nënligjor që synon ndërhyrje në një fushë të caktuar të komunikimit elektronik dhe kufizim në internet të një kategorie të gjerë përdoruesish. Ndërprerja e aksesit në platformën *on-line* nuk mbështetet në dispozitat e ligjit për komunikimet elektronike dhe as në dispozitat e ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Në këtë kuptim, është cenuar edhe *parimi i hierarkisë së normave juridike*, pasi akti nuk ka dalë në bazë dhe për zbatim të një ligji, pra është miratuar pa autorizimin e shprehur të ligjvënësit.

7.3.2.2. Për sa i përket kriterit të “interesit publik”, nuk provohet ekzistenca e një rreziku të qartë dhe konkret për interesin publik për ndërmarrjen e një mase kaq ekstreme. Nuk ekzistojnë të dhëna që tregojnë një kërcënim të menjëhershëm ndaj rendit publik dhe platforma nuk është përdorur për terrorizëm ose destabilizim.

7.3.2.3. Lidhur me kriterin e proporcionalitetit, masa është e ashpër dhe e menjëhershme, ndërsa ndalimi është i përgjithshëm, pasi prek një kategori të gjerë përdoruesish dhe jo vetëm kategorinë e fëmijëve, në kundërshtim me qasjen e vendeve evropiane. Po ashtu, mbrojtja e të dhënave personale mund të realizohet edhe me masa më pak të ashpra. Gjithashtu, nuk justifikohet mjaftueshëm objektivi që synohet të arrihet. VKM-ja zgjedh të

ndalojë tërësisht një rrjet social të përdorur nga mijëra qytetarë, në vend që të synojë përmbajtjen specifike që mund të konsiderohet problematike brenda platformës. Kjo masë shkon përtej nevojës për të mbrojtur sigurinë publike ose interesin publik dhe përbën një kufizim joproporcional e të panevojshëm. Argumentet e përdorura nga subjekti i interesuar janë të përgjithshme dhe të paprovuara me statistika. Po kështu, edhe periudha 12-mujore e ndalimit është e paargumentuar. Një masë alternative do të ishte zbatimi i rregullave të përmirësimit të përmbajtjes ose forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes.

8. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

8.1. *Për legjitimitimin e kërkueseve*

Kërkueset nuk kanë argumentuar, nga pikëpamja kushtetuese, cenimin e lirisë së shprehjes, të shtypit dhe së drejtës për informim si rrjedhojë e zbatimit të VKM-së nr. 151/2025, si dhe nuk kanë përcaktuar interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Ato nuk kanë argumentuar as cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme në kuptim të nenit 4 të Kushtetutës. Po ashtu, kërkueset nuk kanë provuar se përfitojnë të ardhura nga platforma “TikTok”, ndërsa nga të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se vetëm një anëtar i tyre ka status aktiv në ushtrimin e aktivitetit tregtar, kurse të tjerët janë të pezulluar ose të çregjistruar. Kërkueset nuk mund të pretendojnë mbrojtjen e interesave kolektivë, për sa kohë ato nuk provojnë se funksionojnë dhe përfaqësojnë realisht interesat që pretendojnë se mbrojnë dhe se veprimtaria për të cilën janë krijuar është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë, aktuale dhe vetjake nga akti i kundërshtuar.

8.2. *Për themelin e pretendimeve*

8.2.1. Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i pabazuar, pasi kërkueset nuk kanë parashtruar se cila prej tyre përfiton të ardhura nga platforma “TikTok”. Ky pretendim mbetet në nivel hipotetik dhe i pambështetur në prova konkrete.

- 8.2.2. Pretendimi për cenimin e *lirisë së shprehjes, të shtypit dhe së drejtës për informim* është i pabazuar, pasi ndalimi i platformës ka qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, është nxjerrë në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe me ligjet sektoriale, si dhe ka afat deri në 12 muaj. Ndalimi i përkohshëm i vetëm një platforme sociale nuk cenon në mënyrë të pajustificuar lirinë e shprehjes, por synon të adresojë përhapjen e përmbajtjeve të rrezikshme, dezinformimin dhe rreziqet për sigurinë publike, veçanërisht tek të miturit. Gazetarët dhe qytetarët mbeten të lirë të përdorin aplikacione të tjera për t'u shprehur dhe për të marrë informacion. E drejta për informim nuk nënkupton akses të pakufizuar në çdo platformë *on-line*.
- 8.2.3. Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme* është i pabazuar, pasi kërkueset nuk kanë paraqitur prova dhe argumente të mjaftueshme për të provuar sesi janë ndikuar nga pezullimi i platformës “TikTok”. VKM-ja është nxjerrë në bazë të dispozitave të qarta kushtetuese dhe ligjore dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të miturve dhe të dhënave personale. Masa e ndalimit të përkohshëm nuk krijon situatë arbitrare ose retroaktive dhe pretendimi i humbjes të të dhënave të përdoruesve nuk është pasojë e drejtpërdrejtë e VKM-së.
- 8.2.4. Pretendimi se masa e marrë me VKM-në objekt kundërshtimi nuk përmbush kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave, sipas nenit 17 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi:
- 8.2.4.1. Në lidhje me kriterin “vetëm me ligj”, VKM-ja është miratuar në bazë dhe për zbatim të ligjeve për komunikimet elektronike dhe për të drejtat e fëmijëve, të cilat parashikojnë shprehimisht kufizimin e aksesit në platforma apo rrjete kompjuterike ose të informacionit dhe autorizojnë Këshillin e Ministrave për këtë qëllim. Gjithashtu, VKM-ja është në përputhje me strategjitë kombëtare që kanë në fokus mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve.
- 8.2.4.2. Lidhur me kriterin e “interesit publik”, VKM-ja përbën një politikë

shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe kufizimi është i nevojshëm për arsye të interesit publik, të cilat lidhen me shmangien e ndikimeve që kjo platformë ka në nxitjen e dhunës, veçanërisht te fëmijët, në shkaktimin e problemeve të zhvillimit psiko-social të tyre, në shkaktimin e problematikave sociale në tërësi dhe në mbrojtjen e të dhënave personale.

8.2.4.3. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit, masa është proporcionale, e nevojshme dhe nuk prek thelbin e së drejtës, sepse ekziston një raport i drejtë midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar. Nevoja e ndërhyrjes ka qenë reale dhe e menjëhershme, ndërsa pretendimet e kërkueseve nuk shoqërohen me prova konkrete. Kjo nevojë për miratimin e masës ka pasur pikënisjen nga një ngjarje e rëndë, si pasojë e së cilës ndërroi jetë një i mitur, si dhe është mbështetur në raportet dhe statistikën për përdorimin e kësaj platforme. Disa institucione të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore kanë shprehur dakordësinë për këtë ndërhyrje. Problematika e sigurisë në përdorimin e kësaj platforme është fenomen global dhe shumë shtete kanë marrë masa për kufizimin e përdorimit të saj. Vetë natyra e masës nuk ka për qëllim kufizimin e përhershëm, por pezullimin dhe rihapjen e platformës. Në këtë mënyrë, përmbushen nënkriteret e nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë. Ndalimi i përgjithshëm i platformës është masë e përkohshme dhe e jashtëzakonshme, e marrë në kushtet e urgjencës dhe nuk përbën masën më të ashpër të mundshme, pasi kufiri maksimal i saj është 12 muaj. Nga ana tjetër, për marrjen e informacionit ose për shprehjen e lirë ekzistojnë alternativa të tjera.

9. ***Subjektet e interesuara, AKSK-ja dhe AKSHI***, nuk u paraqitën në seancë plenare, ndërsa në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës janë shprehur se mbështesin qëndrimin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

10. ***Avokati i Popullit***, në mendimin me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar

si vijon:

- 10.1. Në lidhje me garantimin e *lirisë së shprehjes*, mungesa e mjeteve efektive për të ndaluar abuzimet me të njëjtin efektivitet si në mjedisin tradicional nuk mund të shërbejë si bazë për të legjitimuar mosrespektimin e dinjitetit të personit, ndërsa përdoruesit ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes. Nga ana tjetër, ndërprerja *apriori* e aksesit në rrjetet sociale, pa një bazë të qartë ligjore dhe në mungesë të një ndërhyrjeje proporcionale, përbën një cenim të drejtpërdrejtë të lirisë së shprehjes. Ndërhyrja e shtetit në këto kushte mund të cilësohet si formë e censurës moderne dhe është në kundërshtim me standardet demokratike dhe detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjetja e mekanizmave teknikë për bllokimin ose filtrimin e materialeve *on-line* është një proces kompleks, i cili duhet të paraprihet nga një bazë e plotë ligjore për kufizimin e lirisë së shprehjes në internet. Këto masa duhet të kenë karakter parandalues dhe nuk mund të zëvendësojnë masat penalizuese që ekzistojnë në legjislacionin penal. Marrja e një mase ekstreme, qoftë edhe për një periudhë të kufizuar kohore, ngre pikëpyetje të forta lidhur me përmbushjen e testit të proporcionalitetit dhe nuk duhet të cenojë shtetin e së drejtës. Precedenti i krijuar në këtë rast përbën një rrezik shumë të madh, ndonëse nuk prek thelbin e së drejtës, për sa kohë e drejta për të përdorur platforma të tjera ose përdorimi i internetit nuk janë kufizuar. Neni 17 i Kushtetutës ka parashikuar garancinë se kufizimi duhet të vijë si pasojë e vullnetit të shprehur të ligjvënësit me miratimin e një ligji specifik dhe jo nga kompetenca të ushtruara nga organe të tjera shtetërore. Kufizimi nuk është vendosur me ligj, çka tregon se nuk përmbush kriterin themelor të ligjshmërisë.
- 10.2. Në lidhje me garantimin e *së drejtës së privatësisë*, përdorimi i teknologjisë nuk mund të konsiderohet neutral ndaj të drejtave të individit. Fakti që kjo paketë ligjore hyn në fuqi pas dy vjetësh nga miratimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nuk mund të justifikojë një ndërhyrje kaq të thellë dhe potencialisht të rrezikshme në të drejtat themelore. Të drejtat e individit nuk mund të “pezullohen” për shkak të mungesës së dispozitave të zbatueshme. Parimi i proporcionalitetit dhe mbrojtja e të drejtave të individit kanë karakter të menjëhershëm dhe nuk mund të shtyhen për një moment të mëvonshëm.

10.3. Në lidhje me *cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme*, referuar legjislacionit në fuqi, rregullimi normues i përdorimit të platformave *on-line* ose rrjeteve sociale është i paplotë dhe i fragmentuar. Mungesa e një legjislacioni të qartë dhe të plotë rregullator për ushtrimin e veprimtarisë normale të platformave *on-line/rrjeteve sociale*, si edhe e mekanizmave monitorues dhe kontrollues për këtë qëllim, përbën një premisë të dukshme për cenimin e parimit të sigurisë juridike në këtë fushë dhe, për më tepër, edhe për cenimin e pritshmërive të ligjshme të operatorëve që ofrojnë akses në këto platforma, si dhe të përdoruesve të tyre.

III

Procesi në Gjykatën Kushtetuese

11. Në datën 04.02.2026 subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për pushimin e gjykimit të çështjes, me argumentin se në datën 03.02.2026 është miratuar vendimi nr. 62 “Për heqjen e masave të përkohshme për platformën *on-line* “TikTok”” (VKM-ja nr. 62/2026), ku në pikën 3 të tij është vendosur shfuqizimi i VKM-së nr. 151/2025. Në këto kushte, sipas subjektit të interesuar, për sa kohë akti objekt i kontrollit kushtetues është shfuqizuar, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.

12. Gjykata vëren se, sipas VKM-së nr. 62/2026, është vendosur heqja e masave të përkohshme për ndërprerjen e aksesit në platformën *on-line* “TikTok” në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas adresimit të problematikave në fushën e sigurisë publike dhe sociale në mjedisin digjital (*pika 1*). Po kështu, është ngarkuar Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike që, në bashkëpunim me entet rregullatore të fushës, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e heqjes së masave për ndërprerjen e aksesit të kësaj platforme, duke respektuar edhe dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi (*pika 2*). VKM-ja nr. 151/2025 shfuqizohet (*pika 3*). Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, AKSK-ja, AKSHI dhe autoritetet rregullatore sektoriale (*pika 4*).

13. Neni 51, pika 2, i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon se kur një ligj ose akt normativ

ose pjesë të tij që është objekt shqyrtimi para Gjykatës, shfuqizohet ose ndryshohet para se ajo të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror.

14. Në seancën plenare publike të datës 05.02.2026 kërkueset parashtuan se Gjykata duhet të vijojë shqyrtimin e çështjes, pasi akti objekt kontrolli kushtetues paraqitet i papajtueshëm me disa të drejta dhe liri themelore të garantuara nga Kushtetuta. Sipas tyre, natyra dhe rëndësia e këtyre të drejtave krijojnë një interes të qartë publik që justifikon nevojën që Gjykata të shprehet në lidhje me kushtetutshmërinë e aktit në fjalë.

15. Në analizë të kërkesës për pushimin e gjykimit të çështjes dhe argumenteve të palëve në seancën plenare, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës, në përputhje me nenin 51, pika 2, të Ligjit Organik të saj. Në këtë drejtim, Gjykata vlerësoi se çështja objekt shqyrtimi, që lidhet me aktin normativ të Këshillit të Ministrave për ndërprerjen e aksesit në platformën “TikTok”, paraqet interes publik, pasi, *prima facie*, ngre pretendime kushtetuese lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore në mjedisin digjital, midis të tjerave edhe të lirisë së shprehjes, për të cilën Gjykata ka theksuar se përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik dhe një kusht të domosdoshëm për pluralizmin, tolerancën dhe krijimin e vullnetit të lirë politik (*shih vendimet nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). Në veçanti, Gjykata çmoi se pretendimet e parashtuara kërkojnë sqarimin e standardeve kushtetuese që rregullojnë ndërhyrjet e autoriteteve publike në fushën e komunikimit digjital, veçanërisht kur ato marrin formën e bllokimit të përgjithshëm të një platforme *on-line*. Për këtë arsye, pavarësisht shfuqizimit të mëvonshëm të VKM-së, vijimi i gjykimit mbetet i nevojshëm jo vetëm për mbrojtjen efektive të subjekteve të prekura, por edhe për orientimin e veprimtarisë së ardhshme normative dhe administrative të organeve publike. Po kështu, vijimi i gjykimit shërben për të parandaluar që shfuqizimi i mëpasshëm i një akti të tillë të pengojë kontrollin kushtetues të ndërhyrjeve që, edhe pse të përkohshme në kohëzgjatje, janë të afta të prodhojnë pasoja të menjëhershme dhe të rëndësishme në ushtrimin e të drejtave themelore. Në këto kushte, Gjykata arriti në përfundimin se ekziston një interes publik që justifikon vijimin e gjykimit të çështjes.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

16. Kërkuëset kanë pretenduar se Gjykata ka juridiksion për të shqyrtuar VKM-në nr. 151/2025, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, pasi ky akt: (i) zbatohet në të gjithë territorin dhe u drejtohet të gjithë përdoruesve të platformës *on-line* “TikTok”, si atyre aktualë, ashtu edhe atyre potencialë, pra një kategorie të papërcaktuar nominalisht, por të konsideruar në mënyrë abstrakte dhe në tërësinë e saj; (ii) ka vendosur ndërprerjen e aksesit për të gjithë përdoruesit aktual ose potencialë në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke parashikuar kështu rregulla të përgjithshme me karakter normativ; (iii) i shtrin efektet e tij në mënyrë të vazhdueshme ndaj subjekteve të papërcaktuara të së drejtës. Lidhur me këtë pretendim, subjektet e interesuara nuk kanë paraqitur prapësime.

17. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës, Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme, prandaj, gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës, Gjykata ndalet paraprakisht te natyra e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj për shqyrtimin substancial të aktit (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 86, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka theksuar se akti normativ vendos norma të përgjithshme sjelljeje me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre për një kategori të pacaktuar subjektësh. Ai është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij. Kurse akti individual është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se natyra normative e aktit është e lidhur me fuqinë e

përgjithshme të tij, në pikëpamje të aftësisë për të prekur situatën juridike të personave juridikë apo fizikë, me anë të krijimit të të drejtave ose detyrimeve për ta. Në disa raste, nga zbatimi i një akti normativ, mund të përcaktohet numri ose identifikimi i personave për të cilët ai zbatohet në një kohë të caktuar, megjithatë ky fakt nuk vë në dyshim fuqinë e përgjithshme të aktit normativ, për sa kohë parashikohet që zbatohet ndaj tyre për shkak të situatës objektive faktike dhe ligjore të përcaktuar në të. Po ashtu, edhe pse një akt mund të ketë në përmbajtjen e tij rregulla që u drejtohen personave të veçantë, në mënyrë që i dallon ata nominalisht, ky fakt nuk mjafton që akti të marrë natyrë individuale në tërësinë e tij (*shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata, në rastet kur ka shqyrtuar çështje me objekt shfuqizimin e akteve normative, për të cilat kanë juridiksion edhe gjykatat administrative, është shprehur se natyra e pretendimeve të ngritura para saj është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 34, datë 24.04.2024; nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më sipër, Gjykata ka identifikuar tri kritere që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në akt individual ose akt normativ: i) *sipas subjekteve të cilave u drejtohet akti* - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktuar në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; ii) *sipas objektit* - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; iii) *sipas karakterit shterues/joshterues* - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njehershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme (*shih vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në dritën e standardeve të mësipërme jurisprudenciale, Gjykata vlerëson se për të përcaktuar natyrën juridike të VKM-së nr. 151/2025 duhen shqyrtuar subjektet të cilave ajo u drejtohet, objekti që rregullon dhe mënyra e shtrirjes së efekteve të saj. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 151/2025: (i) u drejtohet të gjithë përdoruesve aktualë ose potencialë të

platformës *on-line* në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra një kategori që nuk është e përcaktuar nominalisht, por në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte; (ii) ka për objekt vendosjen e një mase të përgjithshme për ndërprerjen e aksesit në këtë platformë për një afat deri në 12 muaj, afat ky që është lidhur edhe me mundësimin nga ofruesi i platformës të instrumenteve teknike që rregullojnë aksesin e fëmijëve në të, duke vendosur kështu rregulla të përgjithshme sjelljeje; (iii) prodhon efekte që, ndonëse lidhen me një situatë konkrete faktike, nuk shterojnë me të, pasi zbatimi i masës është i lidhur edhe me përmbushjen e një kushti të ardhshëm, çka i jep asaj karakter vazhdues. Në këtë kuptim, fakti që platforma “TikTok” administrohet nga një subjekt privat nuk është element përcaktues për natyrën juridike të aktit të kundërshtuar, për sa kohë ky i fundit nuk rregullon në mënyrë individuale pozitën juridike të atij subjekti, por vendos një rregull të përgjithshëm për aksesin në atë platformë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për zbatimin e masave përkatëse nga autoritetet publike, me efekte ndaj një numri të pacaktuar subjektësh.

23. Në përfundim, duke pasur parasysh karakterin normativ të aktit të kundërshtuar, si dhe natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara, Gjykata çmon se VKM-ja objekt kundërshtimi bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për legjitimimin e kërkueseve

24. Çështjen e legjitimitit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin të provojnë interesin e tyre dhe lidhjen ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për legjitimimin e organizatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes të mjaftueshëm bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyrë ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe konkrete që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes

konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 58 datë 15.10.2025; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kërkueset kanë pretenduar se legjitimohen *ratione personae*, pasi janë regjistruar si persona juridikë në gjykatë dhe gëzojnë personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Po kështu ato kanë pretenduar se legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar. Kërkueset kanë pretenduar edhe se legjitimohen edhe *ratione materiae*, pasi VKM-ja e kundërshtuar ka prekur interesa të drejtpërdrejtë të tyre dhe objektin e veprimtarisë së tyre, të parashikuar në statut, si dhe cenon të drejtat dhe liritë që kërkueset synojnë të mbrojnë. Po sipas tyre, VKM-ja ka cenuar mënyrën e ushtrimit të profesionit të gazetarëve dhe funksionimin e medias, nga njëra anë, dhe të drejtën e individëve për t'u shprehur lirisht, nga ana tjetër, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet objektit të organizatave dhe fushës së rregulluar nga akti normativ.

27. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkueset nuk kanë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese cenimin e lirisë së shprehjes, të shtypit dhe së drejtës për informim si rrjedhojë e zbatimit të VKM-së nr. 151/2025 ose pasojat e ardhura për këtë shkak, si dhe nuk kanë përcaktuar interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Sipas këtij subjekti, kërkueset nuk kanë argumentuar as cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme në kuptim të nenit 4 të Kushtetutës. Kërkueset nuk kanë provuar se përfitojnë të ardhura nga platforma “TikTok” dhe, referuar të dhënave të QKB-së, vetëm një anëtar rezulton me status aktiv në ushtrimin e aktivitetit tregtar, ndërsa të tjerët rezultojnë të pezulluar ose të çregjistruar. Sipas subjektit të interesuar, kërkueset nuk mund të pretendojnë mbrojtjen e interesave kolektivë, për sa kohë nuk provojnë se funksionojnë dhe përfaqësojnë realisht interesat që pretendojnë të mbrojnë, si dhe nuk provojnë me fakte konkrete se veprimtaria për të cilën janë krijuar është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë, aktuale dhe vetjake nga akti i kundërshtuar. Për rrjedhojë, sipas subjektit të interesuar, pretendimi i kërkueseve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike mbetet në nivel hipotetik dhe i pambështetur në prova konkrete. Këtë qëndrim e kanë mbështetur edhe dy subjektet e tjera të interesuara, AKSK-ja dhe AKSHI.

28. Në lidhje me legjitimitimin e kërkueseve, Gjykata çmon se kriteri *ratione personae*, duke

qenë se lidhet me qëllimin sipas statutit, strukturën organizative dhe veprimtarinë konkrete të tyre, duhet të analizohet veçmas për secilën prej kërkueseve. Ndërsa për kriteret e tjera të legjitimitit, për aq sa ato lidhen me të njëjtin akt normativ, të kundërshtuar përmes së njëjtës kërkesë dhe mbi bazën e të njëjtave pretendime, analiza do të vijojë së bashku për të dyja kërkueset.

Shoqata “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë”

29. Gjykata vëren se kërkuesja, shoqata “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë”, është person juridik i regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 7265, datë 19.02.2024. Sipas nenit 11 të statutit, organet drejtuese janë asambleja e përgjithshme, bordi dhe kryetari. Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqatës, i cili zgjedh dhe shkarkon anëtarët e bordit (*neni 12*). Ky i fundit është organi përgjegjës për kontrollimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqatës, si dhe mbikëqyr përfaqësimin nga kryetari përpara palëve të treta (*neni 14*). Si kryetar i parë është caktuar Isa Myzyraj (*neni 25*). Me autorizimin e datës 17.03.2025, kryetari ka autorizuar avokatin Franc Terihati për të përfaqësuar shoqatën në Gjykatë për kundërshtimin e VKM-së nr. 151/2025. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* në aspektin formal për t’iu drejtuar Gjykatës.

30. Referuar nenit 6 të statutit të saj, shoqata ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të gazetarëve, kameramanëve, fotoreporterëve dhe të gjithë punonjësve të tjerë të medias, si dhe promovimin e gazetarisë së lirë, investiguese, të pavarur dhe profesionale. Këtë qëllim ajo e realizon, ndër të tjera, nëpërmjet përfaqësimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe interesave të gazetarëve dhe të gjithë punonjësve të medias pranë autoriteteve publike. Anëtarë themelues të saj janë shtatë shtetas shqiptarë, me profesion gazetarë.

31. Duke iu referuar përmbajtjes së kërkesës, Gjykata vëren se kërkueset kanë pretenduar: cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike*, pasi ndalimi i aksesit në platformë ka sjellë pasoja për median, bizneset, industrinë e muzikës, turizmin dhe gastronominë; cenimin e *lirisë së shprehjes, të shtypit dhe së drejtës për informim*, pasi kufizohet aksesit i qytetarëve, gazetarëve dhe bizneseve në një nga hapësirat kryesore dhe më gjithëpërfshirëse të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit në epokën digjitale; si dhe cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi VKM-ja nuk ka parashikuar asnjë periudhë tranzicioni, duke i lënë përdoruesit e platformës në një gjendje paqartësie dhe pamundësie efektive për t’i përshtatur

aktivitetet e tyre në mënyrë të rregullt dhe pa pasoja kaq të rënda.

32. Në vlerësim të legjitimitetit *ratione personae* në aspektin substancial, Gjykata vëren se, sipas qëllimit për të cilin është krijuar, shoqata “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë” ka për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të gazetarëve dhe punonjësve të medias, si dhe promovimin e gazetarisë së lirë, të pavarur dhe profesionale. Në këtë kuptim, interesi i saj për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues nuk mund të shtrihet edhe mbi pasojat e përgjithshme që akti i kundërshtuar mund të ketë sjellë për kategori të ndryshme subjektësh, si bizneset, industria e muzikës, turizmi, gastronomia ose qytetarët në përgjithësi. Megjithatë, ky interes ekziston për ato pretendime që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e të drejtave dhe lirive të gazetarëve dhe punonjësve të medias që ajo synon të mbrojë, si edhe me përdorimin e platformave digjitale si hapësira të komunikimit publik dhe të shpërndarjes së informacionit.

33. Edhe pse VKM-ja nr. 151/2025 është shfuqizuar më pas, kjo rrethanë nuk e shuan vetvetiu interesin e kërkuësës për shqyrtimin kushtetues të kërkesës, për sa kohë akti i kundërshtuar ka qenë në fuqi dhe ka qenë i aftë të prodhojë pasoja të drejtpërdrejta në fushën e veprimtarisë që ajo, sipas statutit, synon të mbrojë. Po ashtu, shfuqizimi i mëvonshëm i aktit nuk është shoqëruar me njohjen e cenimit të pretenduar dhe as me ndonjë masë për korrigjimin e pasojave të mundshme të ardhura gjatë kohës së zbatimit të tij. Për rrjedhojë, interesi i kërkuësës, për ato pretendime që lidhen drejtpërdrejt me qëllimin e saj dhe me veprimtarinë që ushtron, vijon të ruajë aktualitetin.

34. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* për pretendimet që, sipas përmbajtjes së tyre, lidhen me ushtrimin e të drejtave dhe lirive të gazetarëve dhe punonjësve të medias që ajo synon të mbrojë, si edhe me qëllimin për të cilin është krijuar, ndërsa për pretendimet që lidhen me të drejtat e kategorive të tjera të subjekteve, ajo nuk legjitimohet, pasi ato nuk lidhen drejtpërdrejt me qëllimin e saj sipas statutit dhe me një interes kushtetues të drejtpërdrejtë e konkret.

Qendra BIRN Albania

35. Gjykata vëren se kërkuësja, Qendra BIRN Albania, është person juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 554, datë 07.10.2009. Referuar nenit 9 të statutit, organi më i lartë vendimmarrës është bordi i drejtorëve. Organi më i lartë ekzekutiv është drejtori ekzekutiv, që zgjidhet për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rimandatimi (*neni 11*), i cili

përfaqëson ligjërisht qendrën në marrëdhënie me të tretët dhe në konfliktet gjyqësore (*neni 14*). Me vendimin e datës 20.03.2014, bordi i drejtorëve ka vendosur emërimin e drejtoreshës ekzekutive Kristina Voko. Me autorizimin e datës 17.03.2025, kjo e fundit ka autorizuar avokatin Franc Terihati për të përfaqësuar qendrën në Gjykatë për kundërshtimin e VKM-së nr. 151/2025. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* në aspektin formal për t'iu drejtuar Gjykatës.

36. Në vlerësim të legjitimitetit *ratione personae* në aspektin substancial, Gjykata vëren se, sipas përmbajtjes së nenit 5 të statutit, Qendra ka për qëllim forcimin e demokracisë dhe lirisë së shprehjes, si dhe promovimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, përmes forcimit të kapaciteteve të medias së shkruar, elektronike dhe *on-line*; ngritjes profesionale të gazetarëve shqiptarë; rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e grupeve të cënueshme; promovimit të parimeve të transparencës, drejtësisë dhe llogaridhënies së organeve publike; nxitjes së debatit publik për çështje të rëndësishme politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në vend. Si pjesë e fushës së veprimtarisë, ajo ka, ndër të tjera, organizimin e investigimeve gazetareske në shërbim të publikut të gjerë; promovimin dhe mbështetjen e lirisë së medias, lirisë së shprehjes dhe të informimit, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për këto liri; zhvillimin e publikimeve në forma të ndryshme, si dhe monitorimin e medias, administratës publike, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile, për qëllime të ndryshme studimore ose komerciale. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se, nisur nga qëllimi i saj sipas statutit, kërkuësja ka një interes të drejtpërdrejtë dhe konkret për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues ndaj një akti normativ që pretendohet se ka ndikuar në ushtrimin e veprimtarisë së saj në fushën e lirisë së shprehjes, të lirisë së medias, të publikimeve, të monitorimit dhe të komunikimit me publikun në mjedisin digjital. Për të njëjtat arsye të parashtruara më sipër lidhur me shfuqizimin e mëvonshëm të VKM-së nr. 151/2025, Gjykata çmon se ky interes i kërkuësës vijon të ruajë aktualitetin.

37. Për rrjedhojë, në të njëjtën qasje si më sipër, Gjykata çmon se edhe Qendra BIRN Albania legjitimohet *ratione personae* në aspektin substancial për ato pretendime që, sipas përmbajtjes së tyre, lidhen drejtpërdrejt me qëllimin për të cilin është krijuar dhe me veprimtarinë konkrete që ajo ushtron. Ndërsa për pretendimet që u referohen interesave të përgjithshëm të sektorëve të tjerë ekonomikë ose të publikut në tërësi, kërkuësja nuk legjitimohet.

38. Në lidhje me legjitimitetin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të

Gjykatës, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 151/2025 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 07.03.2025 dhe ka hyrë në fuqi po në këtë datë, ndërsa kërkesa në Gjykatë është paraqitur fillimisht në datën 19.03.2025, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

39. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuueset kanë pretenduar se VKM-ja nr. 151/2025 ka cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike, lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit dhe të drejtën për informim, si dhe parimin e shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme.

40. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike*, Gjykata konstaton se kërkuueset kanë pretenduar se kufizimi i aksesit në platformën “TikTok” ka sjellë pasoja ekonomike, përfshirë kufizimin e burimeve financiare për gazetarët që mbështeten në të për të siguruar të ardhura nëpërmjet publikimit dhe shpërndarjes së lajmeve. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuueset nuk kanë provuar se përfitojnë të ardhura nga kjo platformë dhe se, referuar të dhënave të QKB-së, vetëm një anëtar rezulton me status aktiv në ushtrimin e aktivitetit tregtar, ndërsa të tjerët janë të pezulluar ose të çregjistruar. Në përgjigje të këtyre prapësimeve, kërkuueset kanë parashtruar se platforma *on-line* e bllokuar nga VKM-ja e kundërshtuar ka shërbyer si mjet i rëndësishëm për gjenerimin e ardhurave dhe gjykimi kushtetues nuk duhet të bëhet vetëm në nivel numerik. Megjithatë, në analizë të përmbajtjes së këtij pretendimi, si dhe të të dhënave të paraqitura nga subjekti i interesuar, Gjykata konstaton se kërkuueset nuk kanë arritur të argumentojnë në nivel kushtetues një lidhje të drejtpërdrejtë dhe konkrete ndërmjet aktit të kundërshtuar dhe cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike në raport me vetë kërkuueset ose me interesat që ato përfaqësojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar. Në këtë drejtim, as pretendimi se platforma ka shërbyer si mjet për gjenerimin e të ardhurave dhe as parashikimi në statutin e njëjës prej kërkueseve, Qendrës BIRN Albania, se në fushën e veprimtarisë së saj ka edhe zhvillimin e publikimeve në forma të ndryshme, si dhe monitorimin e medias, administratës publike, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile edhe për qëllime komerciale, nuk mjaftojnë në vetvete për të justifikuar interesin e tyre kushtetues në raport me këtë liri, në mungesë të provës së një ndikimi real, të drejtpërdrejtë dhe konkret. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuueset nuk legjitimohen *ratione materiae* për këtë pretendim.

41. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *lirisë së shprehjes, lirisë së shtypit dhe së*

drejtës për informim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik dhe një kusht të domosdoshëm për pluralizmin, tolerancën dhe krijimin e vullnetit të lirë politik. Ajo ka pohuar se liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, të parashikuara nga nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, janë të lidhura objektivisht me parimin e shtetit demokratik, ndërsa media gëzon një rol të posaçëm në rendin demokratik, pasi kontribuon në kontrollin e ushtrimit të autoritetit publik, rrit transparencën e veprimtarisë shtetërore dhe shërben si instrument i rëndësishëm për kritikën ndaj dukurive që rrezikojnë demokracinë. Në këtë kuptim, shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë të qeverisjes. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se, sipas nenit 10 të KEDNJ-së, liria e shprehjes përfshin në vetvete edhe të drejtën e informimit, si një e drejtë themelore për të marrë dhe për të dhënë informacion pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. E drejta e informimit ndër elementet e saj kryesore ka lirinë personale për të marrë informacion, lirinë personale për të dhënë informacion dhe lirinë e shtypit ose, thënë ndryshe, të drejtën e medias për të marrë e dhënë informacion. Kjo e fundit trajtohet gjithnjë si e drejtë më vete, për shkak të rolit të veçantë që luan media në një shoqëri të lirë e demokratike. Në dallim nga KEDNJ-ja, është shprehur Gjykata, Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj, ndërsa ushtrimi efektiv i këtyre lirive nuk varet vetëm nga mosndërhyrja e shtetit, por mund të kërkojë edhe masa pozitive mbrojtjeje nëpërmjet kuadrit ligjor dhe praktikave përkatëse (*shih vendimet nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në dritën e kësaj jurisprudence, duke pasur parasysh se sipas statuteve të tyre, kërkueset kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, promovimin e gazetarisë, forcimin e lirisë së shprehjes, të lirisë së medias, si dhe nxitjen e qarkullimit të informacionit në hapësirën publike, Gjykata çmon se ato legjitimohen *ratione materiae* për pretendimet që lidhen me kufizimin e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit, për aq sa VKM-ja e kundërshtuar pretendohet se ka ndikuar në ushtrimin e veprimtarisë së tyre në këto drejtime.

43. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit për cenimin e së *drejtës për informim*, Gjykata rithekson se kjo e drejtë, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, përfshin të drejtën e individit të aksesojë, në përputhje me ligjin, fakte dhe të dhëna që lidhen me ushtrimin e pushtetit

publik, në mënyrë që individi i informuar të ketë mundësinë të marrë pjesë në jetën publike. Në thelb, njohja e individit me informacion i mundëson atij formimin e pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë, ndërsa autoritetet publike i nxit në drejtim të integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë (*shih vendimin nr. 7, datë 25.03.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkueset nuk e kanë ndërtuar këtë pretendim në mënyrë të pavarur, të mbështetur posaçërisht në përmbajtjen dhe garancitë e nenit 23 të Kushtetutës, pra si cenim të së drejtës për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore ose të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Po kështu, ato nuk kanë parashtruar argumente konkrete kushtetuese që të tregojnë sesi akti i kundërshtuar ka cenuar, në raport me to dhe me qëllimin për të cilin janë krijuar, këtë të drejtë në kuptimin e veçantë që i jep asaj neni 23 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim si pretendim më vete. Megjithatë, për aq sa argumentet e kërkueseve lidhen me pengimin e shpërndarjes së informacionit nëpërmjet platformës, me kufizimin e komunikimit publik dhe me ndikimin e kësaj mase në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit, këto elemente do të vlerësohen në kuadër të pretendimeve kryesore që burojnë nga neni 22 i Kushtetutës. Gjithashtu, edhe argumentet e lidhura me parimin e shtetit të së drejtës, sigurinë juridike dhe pritshmëritë e ligjshme, për aq sa burojnë nga e njëjta ndërhyrje normative, do të shqyrtohen si argumente mbështetëse të këtyre pretendimeve dhe jo si pretendime më vete.

44. Për sa më sipër, Gjykata çmon të shqyrtojë në themel pretendimin e kërkueseve për cenimin e lirisë së shprehjes dhe të shtypit, të garantuar nga neni 22 i Kushtetutës, duke marrë në konsideratë, si elemente të lidhura me to, edhe argumentet për pengimin e shpërndarjes së informacionit nëpërmjet medias, si dhe ato për sigurinë juridike, për aq sa ato burojnë nga e njëjta ndërhyrje normative.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e lirisë së shprehjes dhe të shtypit

45. Kërkueset kanë pretenduar se VKM-ja e kundërshtuar ka kufizuar në mënyrë të përgjithshme dhe të pakushtëzuar aksesin e gazetarëve dhe organizatave të medias në një nga hapësirat kryesore dhe më gjithëpërfshirëse të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit në epokën digjitale, duke sjellë humbjen e një kanali të rëndësishëm për shpërndarjen e lajmeve, i cili

shërben për komunikimin me audiencën dhe nxitjen e debatit publik, ndërsa qytetarëve u kufizohet aksesin në informacionin që shpërndahet përmes kësaj platforme. Sipas tyre, platforma “TikTok” nuk paraqitet thjesht si një mjet teknik ose si një rrjet social argëtues, por si një hapësirë konkrete komunikimi publik, në të cilën media dhe gazetarët ndërveprojnë me audiencën të veçantë, veçanërisht me grupmoshat e reja, nëpërmjet një formati dhe algoritmi që nuk zëvendësohet mekanikisht nga platformat e tjera dhe që u mundëson shpërndarje të shpejtë dhe organike të përmbajtjes informative. Po kështu, sipas tyre, VKM-ja nuk ka parashikuar asnjë periudhë tranzicioni, duke i lënë përdoruesit e platformës në një gjendje paqartësie dhe pamundësie efektive për t’i përshtatur aktivitetet e tyre në mënyrë të rregullt dhe pa pasoja kaq të rënda, ndërsa për sa i përket medias dëmton procesin e ndërtimit të audiencës dhe angazhimin me publikun.

46. Po ashtu, sipas kërkueseve, masa e marrë me VKM-në e kundërshtuar nuk përmbush kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave, sipas nenit 17 të Kushtetutës. Së pari, kjo ndërhyrje, sipas tyre, nuk përmbush kriterin “vetëm me ligj”, pasi asnjë dispozitë e ligjeve, mbi bazën e të cilëve ka dalë VKM-ja, nuk urdhëron nxjerrjen e një akti të tillë nënligjor dhe ndërprerja e aksesit në platformën *on-line* nuk mbështetet as në dispozitat e ligjit për komunikimet elektronike, as në dispozitat e ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke cenuar edhe parimin e hierarkisë së normave juridike. Së dyti, ajo nuk përmbush kriterin e interesit publik, pasi nuk provohet ekzistenca e një rreziku të qartë dhe konkret për interesin publik për ndërmarrjen e një mase kaq ekstreme, nuk ekzistojnë të dhëna që tregojnë një kërcënim të menjëhershëm ndaj rendit publik dhe platforma nuk është përdorur për terrorizëm ose destabilizim. Së treti, masa nuk përmbush as kriterin e proporcionalitetit, pasi është e ashpër dhe e menjëhershme, ndalimi është i përgjithshëm dhe prek një kategori të gjerë përdoruesish e jo vetëm fëmijët, nuk synon përmbajtjen specifike që mund të konsiderohet problematike brenda platformës, argumentet e përdorura nga subjekti i interesuar janë të përgjithshme dhe të paprovuara me statistika, periudha 12-mujore e ndalimit është e paargumentuar dhe një masë alternative do të ishte zbatimi i rregullave për përmirësimin e përmbajtjes ose forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes.

47. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se pretendimi i kërkueseve është i pabazuar. Sipas tij, ndalimi i përkohshëm i vetëm një platforme sociale nuk cenon në mënyrë të pajustificuar lirinë e shprehjes, ndërsa gazetarët dhe qytetarët mbeten të lirë të përdorin aplikacione të tjera për t’u shprehur dhe për të marrë informacion. Po sipas tij, e drejta për

informim nuk nënkupton akses të pakufizuar në çdo platformë *on-line*. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme, sipas tij, është i pabazuar, pasi kërkueset nuk kanë paraqitur prova dhe argumente të mjaftueshme në mbështetje të tij. Masa e ndalimit të përkohshëm nuk krijon situatë arbitrare ose retroaktive dhe pretendimi i humbjes të të dhënave të përdoruesve nuk është pasojë e drejtpërdrejtë e VKM-së.

48. Po ashtu, sipas subjektit të interesuar, masa e marrë me VKM-në objekt kundërshtimi përmbush kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave, sipas nenit 17 të Kushtetutës. Së pari, në lidhje me kriterin “vetëm me ligj”, VKM-ja është nxjerrë në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe me ligjet sektoriale. Ajo është miratuar në bazë dhe për zbatim të ligjeve për komunikimet elektronike dhe për të drejtat e fëmijëve, të cilat parashikojnë shprehimisht kufizimin e aksesit në platforma apo rrjete kompjuterike ose të informacionit dhe autorizojnë Këshillin e Ministrave për këtë qëllim. Gjithashtu, ajo është në përputhje me strategjitë kombëtare që kanë në fokus mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve. Së dyti, lidhur me kriterin e interesit publik, kufizimi është i nevojshëm për arsye që lidhen me shmangien e ndikimeve që kjo platformë ka në nxitjen e dhunës, veçanërisht te fëmijët, në shkaktimin e problemeve të zhvillimit psiko-social të tyre, në shkaktimin e problematikave sociale në tërësi dhe në mbrojtjen e të dhënave personale. Së treti, për sa i përket kriterit të proporcionalitetit, masa është proporcionale, e nevojshme dhe nuk prek thelbin e së drejtës, pasi nevoja e ndërhyrjes ka qenë reale dhe e menjëhershme. Ajo ka pasur pikënisjen nga një ngjarje e rëndë, prej së cilës ndërroi jetë një i mitur, dhe është mbështetur në raportet dhe statistikën për përdorimin e kësaj platforme, ndërkohë që disa institucione të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore kanë shprehur dakordësinë për këtë ndërhyrje. Problematika e sigurisë në përdorimin e kësaj platforme është fenomen global dhe shumë shtete kanë marrë masa për kufizimin e përdorimit të saj. Vetë natyra e masës nuk ka për qëllim kufizimin e përhershëm, por pezullimin dhe rihapjen e platformës, duke qenë një masë e përkohshme dhe e jashtëzakonshme, me kufi maksimal 12 muaj. Nga ana tjetër, masa nuk ndalon mjetet e komunikimit në mënyrë të përgjithshme dhe për marrjen e informacionit ose për shprehjen e lirë ekzistojnë alternativa të tjera.

49. Në mendimin e tij me shkrim, Avokati i Popullit ka parashtruar se mungesa e mjeteve efektive për të ndaluar abuzimet me të njëjtin efektivitet si në mjedisin tradicional nuk mund të shërbejë si bazë për të legjitimuar mosrespektimin e dinjitetit të personit, ndërsa përdoruesit

ushtrjnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes. Nga ana tjetër, sipas Avokatit të Popullit, ndërprerja *apriori* e aksesit në rrjetet sociale, pa një bazë të qartë ligjore dhe në mungesë të proporcionalitetit, përbën një cenim të drejtpërdrejtë të lirisë së shprehjes dhe mund të cilësohet si formë e censurës moderne, në kundërshtim me standardet demokratike dhe detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sipas tij, gjetja e mekanizmave teknikë për bllokimin ose filtrimin e materialeve *on-line* është një proces kompleks, i cili duhet të paraprihet nga një bazë e plotë ligjore për kufizimin e lirisë së shprehjes në internet, ndërsa neni 17 i Kushtetutës kërkon që kufizimi të vijë si pasojë e vullnetit të shprehur të ligjvënësit me miratimin e një ligji specifik dhe jo nga kompetenca të ushtruara nga organe të tjera shtetërore. Për rrjedhojë, sipas tij, kufizimi nuk është vendosur me ligj dhe për pasojë nuk përmbush kriterin themelor të ligjshmërisë, pasi garancia që kufizimet të vendosen me ligj nuk është formale, por thelbësore dhe absolute. Po ashtu, ai ka vlerësuar se masa është joproporcionale, pasi masa të tilla duhet të kenë karakter parandalues dhe nuk mund të zëvendësojnë masat penalizuese që ekzistojnë në legjislacionin penal, ndërsa marrja e një mase ekstreme, qoftë edhe për një periudhë të kufizuar kohore, ngre pikëpyetje të forta për përmbushjen e testit të proporcionalitetit. Sipas tij, precedenti i krijuar përbën një rrezik shumë të madh, ndonëse nuk prek thelbin e së drejtës, për sa kohë e drejta për të përdorur platforma të tjera ose përdorimi i internetit nuk janë kufizuar në këtë rast. Në fund, ai ka vlerësuar se rregullimi normues i përdorimit të platformave *on-line* ose rrjeteve sociale është i paplotë dhe i fragmentuar, ndërsa mungesa e një legjislacioni të qartë dhe e mekanizmave monitorues e kontrollues për këtë qëllim përbëjnë premisë për cenimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme të operatorëve dhe përdoruesve të këtyre platformave.

50. Neni 22 i Kushtetutës parashikon se liria e shprehjes është e garantuar (pika 1), se liria e shtypit është e garantuar (pika 2), ndërsa censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet (pika 3). Sipas jurisprudencës së Gjykatës, shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë të qeverisjes. Nëpërmjet tyre pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është, gjithashtu, bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Për sa i përket lirisë së shtypit, Gjykata ka pohuar se ajo luan rolin jetik të mbrojtësit

publik në përparimin e një shoqërie demokratike për ta bërë pushtetin shtetëror më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit (*shih vendimin nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar edhe pozitën e posaçme të medias në shtetin demokratik, duke vënë në dukje se ajo e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm, më të kontrollueshëm dhe më transparent, si dhe përbën një bazë të rëndësishme për të gjykuar mënyrën sesi ushtrohet autoriteti publik dhe si administrohen fondet publike. Sipas saj, liria e shtypit dhe e informacionit mediatic i japin publikut njërin prej mjeteve më të mira për zbulimin dhe formimin e një opinioni mbi idetë, veprimet dhe sjelljet e liderëve politikë. I takon shtypit të japë dhe të shpërndajë informacione e ide mbi çështjet politike dhe çështje të tjera të interesit publik. Por jo vetëm shtypi ka detyrën të japë një informacion të tillë, edhe publiku ka të drejtë ta marrë dhe ta përvetësojë atë (*shih vendimet nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka vlerësuar se liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj, si dhe vetërealizimin e çdo individi. Paragrafi 2 i nenit 10 të Konventës zbatohet jo vetëm për “informacionet” ose “idetë” që priten mirë ose konsiderohen si të padëmshme ose si çështje indiference, por edhe për ato që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësisë, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike” (*shih Mouvement Raëlien Suisse kundër Zvicrës, datë 13.07.2012, § 48*). Po sipas saj, neni 10 i KEDNJ-së mbron jo vetëm thelbin e ideve dhe informacionit të shprehur, por edhe formën në të cilën ato përcillen (*shih De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës, datë 24.02.1997, § 48*). Po kështu, GJEDNJ-ja ka theksuar se shtypi luan një rol thelbësor si mbikëqyrës publik (“*public watchdog*”) në një shoqëri demokratike, ndaj kufizimet ose masat që prekin veprimtarinë e medias kërkojnë një shqyrtim veçanërisht të kujdesshëm (*shih Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë [DHM], datë 20.05.1999, § 59*). Në lidhje me rëndësinë e internetit në ushtrimin e lirisë së shprehjes, GJEDNJ-ja ka theksuar se, duke pasur parasysh aksesueshmërinë dhe kapacitetin e tij për të ruajtur dhe komunikuar sasi të mëdha informacioni, interneti luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit të publikut në lajme dhe në lehtësimin e përhapjes së informacionit në përgjithësi (*shih Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe 2), datë 10.03.2009, § 27*). Gjithashtu, ajo ka pohuar se mundësia që individët të shprehen në internet përbën një mjet të paprecedent për ushtrimin e lirisë së shprehjes (*shih Delfi AS kundër*

Estonisë [DHM], datë 16.06.2015, § 110).

53. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se komunikimi, ndërveprimi dhe shpërndarja e informacionit nëpërmjet platformave *on-line* përfshihen në fushën e mbrojtjes së nenit 22 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ-së, për aq sa këto platforma shërbejnë si hapësira të debatit publik, të informimit dhe, sipas rastit, të ushtrimit të lirisë së shtypit, kur përdoren nga media dhe gazetarët për komunikim publik dhe ndërveprim me audiencën.

54. Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueseve për cenimin e të drejtave kushtetuese të garantuara nga neni 22 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ-së, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, do të shqyrtojë fillimisht nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueseve për lirinë e shprehjes dhe të shtypit. Në vijim, nëse konstaton se ka pasur një ndërhyrje të tillë, Gjykata do të vlerësojë nëse ajo, në këndvështrim të nenit 17 të Kushtetutës, ka qenë e justifikuar, pra nëse është bërë me ligj, nëse ka ndjekur një interes publik ose një qëllim të ligjshëm dhe nëse ka qenë proporcionale, domethënë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

55. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së është pranuar se bllokimi i aksesit në faqe ose platforma interneti përbën ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes, në kuptim të nenit 10 të KEDNJ-së, për sa kohë prek të drejtën për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe ide. Në veçanti, ajo ka vlerësuar se masa të tilla, kur kufizojnë aksesin në hapësira komunikimi dhe shpërndarjeje informacioni në internet, prekin ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe, sipas rastit, edhe lirinë e shtypit në mjedisin digjital. Në kontekstin e bllokimit të përgjithshëm të YouTube, GJEDNJ-ja e ka konsideruar atë një “platformë unike” për ushtrimin e lirisë së shprehjes, për shkak të karakteristikave, aksesueshmërisë dhe potencialit të saj për t'u mundësuar përdoruesve marrjen dhe transmetimin e informacionit dhe ideve (*shih Ahmet Yıldıırım kundër Turqisë, datë 18.12.2012, §§ 54-55; Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 01.12.2015, §§ 52, 56*).

56. Në dritën e përmbajtjes së nenit 22 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës së mësipërme kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, dhe duke pasur në vëmendje rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të internetit si mjet kryesor i komunikimit dhe i informimit publik në kushtet e zhvillimit të shpejtë të teknologjisë digjitale, Gjykata çmon se platformat *on-line*, për aq

sa shërbejnë si hapësira të komunikimit publik, të shpërndarjes dhe marrjes së informacionit dhe ideve, si dhe të ndërveprimit me audiencën, përbëjnë mjete për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe, sipas rastit, edhe të lirisë së shtypit. Për rrjedhojë, çdo masë që kufizon ose pamundëson aksesin në platforma të tilla është e aftë të përbëjë ndërhyrje në ushtrimin e këtyre lirive.

57. Në rastin konkret, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 151/2025 ka parashikuar ndërprerjen e aksesit në platformën “TikTok” në territorin e Republikës së Shqipërisë për një afat 12-mujor, deri në mundësimin, nga ofruesi i platformës, të instrumenteve teknike që rregullojnë aksesin e fëmijëve në këtë platformë dhe në materiale të dëmshme për ta. Duke pasur parasysh natyrën e kësaj mase, shtrirjen e saj të përgjithshme ndaj të gjithë përdoruesve, si dhe faktin se kërkueset pretendojnë se platforma në fjalë përbën një hapësirë konkrete komunikimi publik, shpërndarjeje informacioni dhe ndërveprimi me audiencën për median dhe gazetarët, Gjykata çmon se platforma “TikTok”, në rrethanat e çështjes, përbën një mjet për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit. Për rrjedhojë, masa e vendosur me VKM-në e kundërshtuar përbën ndërhyrje në ushtrimin e këtyre lirive, në kuptim të nenit 22 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ-së, për aq sa ajo prek drejtpërdrejt veprimtarinë e kërkueseve në fushën e mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit.

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar

58. Gjykata do të vlerësojë në vijim, sikurse u parashtrua në paragrafin 54 të këtij vendimi, nëse ndërhyrja në të drejtën e kërkueseve për lirinë e shprehjes dhe të shtypit ka qenë e justifikuar, pra, nëse ajo respekton kriteret kushtetuese të kufizimit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, si dhe standardet përkatëse të zhvilluara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

i) Nëse ndërhyrja është bërë me ligj

59. Në lidhje me kriterin nëse ndërhyrja është bërë me ligj, Gjykata ka theksuar se qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve të të drejtave themelore dhe, për këtë shkak, kompetenca për vendosjen e tyre i përket vetëm organit ligjvënës. Shprehja “vetëm me ligj” nënkupton se, në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, ky vlerësim i përket ligjvënësit dhe jo organeve të tjera shtetërore. Në këtë kuptim, rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore vetëm me ligj

ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është vetëm Kuvendi (*shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Po kështu, neni 118 i Kushtetutës ka përcaktuar rezervën ligjore, nëpërmjet së cilës kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se rezerva ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete, e rregulluar pjesërisht me ligj, të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, por duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i ushtruar brenda kufijve të kushtetutshmërisë (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, shprehja “e parashikuar me ligj” kërkon që ligji në të njëjtën kohë të jetë mjaftueshmërisht i aksesueshëm dhe i parashikueshëm, domethënë i formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar individit të parashikojë pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Në çështje që prekin të drejta themelore, do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit, një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike të mishëruara në KEDNJ, që një diskrecion ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehej në terma të një pushteti të pakufizuar. Për rrjedhojë, ligji duhet të ofrojë një masë mbrojtjeje juridike kundër ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve publike në të drejtat e garantuara nga Konventa dhe të tregojë me qartësi të mjaftueshme shtrirjen e çdo diskrecioni të dhënë autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij (*shih OOO Flavus dhe të tjerë kundër Rosisë, datë 23.06.2020, § 30*).

62. Bazuar në standardet e mësipërme dhe nisur nga fakti se kufizimi në rastin konkret është bërë përmes një akti nënligjor, Gjykata do të verifikojë nëse ligji ka parashikuar një autorizim të qartë, të posaçëm dhe të parashikueshëm për këtë kufizim, në kuptimin që i ka deleguar Këshillit të Ministrave kompetencën për të përcaktuar detajet konkrete të tij, pra nëse akti i kundërshtuar është hartuar në përputhje me rezervën ligjore relative.

63. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 151/2025 ka dalë në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit për komunikimet elektronike, ligjit për mediat audiovizive dhe ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Sipas ligjit për komunikimet elektronike, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike që mbikëqyr kuadrin

rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave (*neni 10, pika 1*). Çdo sipërmarrës është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për arsye të interesit publik, sigurisë publike ose shëndetit publik (*neni 26, pika 1*). Masat kombëtare në lidhje me aksesin ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik respektojnë të drejtat themelore dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, dhe çdo masë në lidhje me aksesin ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve që mund të kufizojnë ushtrimin e të drejtave ose lirive duhet të vendoset vetëm nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi dhe respekton ato të drejta ose liri; ajo duhet të jetë proporcionale dhe e nevojshme për përmbushjen e objektivave të interesit të përgjithshëm, të njohura nga legjislacioni në fuqi, ose në nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve (*neni 139, pikat 1 dhe 2*).

64. Ndërsa ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës parashikon se Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, sipas këtij ligji dhe ligjit për sigurinë kibernetike, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe, masa të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (*neni 27, pikat 3 dhe 4*).

65. Në analizë të përmbajtjes së këtyre dispozitave, Gjykata vlerëson se megjithëse ligjet e sipërcituara parashikojnë kompetenca të caktuara rregullatore dhe mbrojtëse në fushën e komunikimeve elektronike dhe të të drejtave të fëmijëve, ato nuk i japin Këshillit të Ministrave një autorizim të qartë, të posaçëm dhe të parashikueshëm për vendosjen e një mase me karakter të përgjithshëm, siç është ndërprerja e plotë e aksesit në një platformë *on-line* për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në veçanti, nenet 26, pika 1, dhe 139, pikat 1 dhe 2, të ligjit për komunikimet elektronike parashikojnë parime të përgjithshme në lidhje me lirinë e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, interesin publik, respektimin e të drejtave themelore, si dhe kërkesat e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë së masave kufizuese, por nuk përcaktojnë vetë natyrën, kushtet, kufijtë dhe garancitë e një ndërhyrjeje kaq intensive në lirinë e shprehjes dhe të shtypit.

66. Po kështu, neni 27, pikat 3 dhe 4, i ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, ndonëse parashikon marrjen e masave për bllokimin e aksesit në rastin e materialeve me përmbajtje të

dëmshme për fëmijët në rrjetet kompjuterike ose faqet e internetit, nuk përcakton në mënyrë të mjaftueshme kriteret materiale, shtrirjen normative dhe kufijtë konkretë mbi bazën e të cilëve Këshilli i Ministrave mund të autorizojë të vendoste bllokimin e përgjithshëm të aksesit në vetë platformën për të gjithë përdoruesit, pa dallim. Gjykata vlerëson se sa më intensive të jetë ndërhyrja në ushtrimin e një të drejte themelore, aq më qartë dhe më hollësisht ligjvënësi duhet të përcaktojë shtrirjen e kompetencave të autoriteteve, kufijtë e ndërhyrjes dhe garancitë kundër arbitraritetit. Në këtë drejtim, edhe sipas mendimit me shkrim të Avokatit të Popullit, gjetja e mekanizmave teknikë për bllokimin ose filtrimin e materialeve *on-line* është një proces kompleks, i cili duhet të paraprihet nga një bazë e plotë ligjore për kufizimin e lirisë së shprehjes në internet.

67. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se nuk rezulton që ligjvënësi të ketë përcaktuar vetë, me qartësinë dhe plotësinë e nevojshme, elementet thelbësore të kufizimit, në mënyrë që akti nënligjor të mbetet brenda funksionit të tij zbatues, në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Në këto kushte, VKM-ja nr. 151/2025 nuk mund të konsiderohet thjesht si akt që detajon teknikisht një kufizim të parashikuar më parë nga ligji, por si akt që ka materializuar vetë kufizimin në elementet e tij thelbësore. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se nuk është respektuar kriteri kushtetues i kufizimit “vetëm me ligj”, sipas nenit 17 të Kushtetutës, në lidhje edhe me nenin 118 të saj.

68. Në këtë pikë, Gjykata çmon se, megjithëse, për efekt të testit të kushtetutshmërisë së ndërhyrjes, konstatimi i mospërbushjes edhe vetëm të njërit prej kriterëve të parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës, siç është ai i kufizimit “vetëm me ligj”, do të mjaftonte për të arritur në përfundimin se ndërhyrja nuk është kushtetuese, është e nevojshme të vijojë shqyrtimi edhe i kriterëve të tjera të kufizimit, duke pasur parasysh natyrën e çështjes, interesin publik që ajo paraqet dhe nevojën për të sqaruar në mënyrë të plotë standardet kushtetuese që rregullojnë kufizimin e lirisë së shprehjes dhe të shtypit në mjedisin digjital².

ii) Nëse ndërhyrja ka ndjekur një interes publik ose qëllim të ligjshëm

² Gjyqtarët Genti Ibrahimit dhe Asim Vokshi mbajtën qëndrimin se për efekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktit normativ të kundërshtuar mjaftonte verifikimi i mospërbushjes së kriterit “vetëm me ligj”. Për këtë arsye, ata vlerësuan të mos shprehen në lidhje me kriteret e tjera të kufizimit.

69. Për sa i përket *kriterit të dytë të kufizimit*, atij të *interesit publik*, Gjykata ka theksuar se është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik dhe që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

70. Në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja ka theksuar se krahas detyrimit negativ të shtetit për të mos ndërhyrë në të drejtat e garantuara nga Konventa, mund të ekzistojnë edhe detyrime pozitive mbrojtjeje dhe në të dyja rastet shteti gëzon njëfarë hapësire vlerësimi (*shih Mouvement Raëlien Suisse kundër Zvicrës, datë 13.07.2012, § 50*). Po ashtu, liria e shprehjes nuk është absolute, por mund t’u nënshtrohet kufizimeve që ndjekin një ose më shumë nga qëllimet legjitime të parashikuara në nenin 10, paragrafi 2, të KEDNJ-së. Sipas saj, edhe pse liria e shprehjes përbën konsideratë parësore dhe përdoruesit e telekomunikacionit dhe të shërbimeve të internetit duhet të kenë garanci që ajo do të respektohet, një garanci e tillë nuk mund të jetë absolute dhe duhet, në raste të caktuara, t’u lëshojë vendin kërkesave të tjera legjitime, të tilla si mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, në veçanti e fëmijëve (*shih K.U. kundër Finlandës, datë 02.12.2008, § 49*). Po kështu, në kontekstin e mjedisit digjital, GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se ndonëse interneti luan një rol të rëndësishëm në ushtrimin e lirisë së shprehjes, ai shoqërohet edhe me rreziqe, si shpifja, gjuha e urrejtjes dhe nxitja e dhunës, të cilat mund të përhapen me shpejtësi shumë të madhe dhe të mbeten të disponueshme për periudha të gjata, duke rënduar ndjeshëm efektet e shprehjes së paligjshme në krahasim me mediat tradicionale (*shih Delfi AS kundër Estonisë [DHM], datë 16.06.2015, §§ 110, 147*). Gjithashtu, ajo ka theksuar se neni 10 i Konventës nuk i garanton shtypit një liri krejtësisht të pakufizuar të shprehjes, madje as në lidhje me pasqyrimin mediatik të çështjeve me interes serioz publik, pasi, gjatë ushtrimit të kësaj lirie, ai duhet të veprojë në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që burojnë nga neni 10, paragrafi 2, i KEDNJ-së (*shih Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe 2), datë 10.03.2009, § 42*).

71. Gjykata vëren se, sipas relacionit shpjegues të VKM-së, qëllimi i miratimit të saj është marrja e masave për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok” në nxitjen e

dhunës veçanërisht të fëmijët, shkaktimin e problemeve të zhvillimit psiko-social të tyre, si dhe shkaktimin e problematikave sociale në tërësi. Po sipas relacionit, masa synon përmirësimin e cilësisë së jetës, minimizimin e rasteve të dhunës dhe bullizmit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien emocionale ose sociale, si dhe marrjen e masave konkrete me qëllim fuqizimin e kapaciteteve për identifikimin, raportimin dhe menaxhimin efektiv të këtyre fenomeneve, si rezultat i nevojës urgjente për veprime të koordinuara për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve. Gjithashtu, një ndër problematikat kryesore është hapja e llogarive të rreme në rrjetet sociale duke përdorur imazhe ose të dhëna të subjekteve pa pëlqimin e tyre, gjë që sjell pasoja në shkeljen e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, dëmtimin e reputacionit dhe imazhit publik, bullizmin, ngacmimin, cenimin e sigurisë *on-line* dhe hakerimin e informacionit. Bazuar në statistikat e referuara nga subjekti i interesuar, për vitin 2024 rezultojnë 80 raportime nga fëmijë dhe të rinj që lidhen me përdorimin e rrjeteve sociale, nga të cilat 56 vetëm me përdorimin e platformës “TikTok” për sa i përket bullizmit, denigrimit të figurës, ekspozimit të imazhit, shantazhimit, mashtrimit, dhunës dhe kërcënimit. Këto të dhëna, sipas subjektit të interesuar, dëshmojnë për një problematikë konkrete dhe jo thjesht hipotetike në përdorimin e kësaj platforme nga të miturit.

72. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se përmbushet kriteri i dytë i kufizimit, ai i interesit publik ose i qëllimit të ligjshëm, i cili, në rastin konkret, konsiston në mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të mirë të fëmijëve, si dhe në mbrojtjen e të rinjve. Ky interes publik gjen mbështetje të drejtpërdrejtë edhe në nenin 54 të Kushtetutës, sipas të cilit fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, ndërsa çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe çdo situatë që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose zhvillimin e tij normal. Me fjalë të tjera, neni 54 i Kushtetutës përbën detyrim pozitiv për shtetin për të siguruar mbrojtje efektive për fëmijët dhe të rinjtë ndaj rreziqeve që mund të paraqiten në mjedisin digjital.

73. Megjithatë, ekzistenca e këtij interesi publik, e mbështetur edhe në të dhënat statistikore të referuara nga subjekti i interesuar, nuk është e mjaftueshme, në vetvete, për të zgjidhur çështjen kushtetuese të domosdoshmërisë së bllokimit të përgjithshëm të platformës, e cila do të vlerësohet nga Gjykata në kuadër të testit të proporcionalitetit. Në këtë drejtim, Gjykata mban në konsideratë edhe faktin se subjekti i interesuar ka sjellë në vëmendje se problematika e sigurisë të të miturve

në raport me platformën “TikTok” nuk paraqitet si fenomen i izoluar, por si çështje që ka nxitur reagime dhe masa kufizuese edhe në juridiksione të tjera.

iii) Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë

74. Për sa i përket kriterit tjetër, atij të *proporcionalitetit të ndërhyrjes*, Gjykata ka pohuar se në thelb të tij qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t’i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Masat mund të jenë të shumëllojshme, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i ushtrimit të së drejtës të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i saj (*shih vendimet nr. 37, datë 01.12.2022; nr. 52, datë 05.12.2012; nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Gjykata ka theksuar gjithashtu se parimi i proporcionalitetit imponon evidentimin e nevojës reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç kësaj, përdorimi i mjeteve kufizuese duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet të cilëve u cenohen të drejtat dhe liritë. Po kështu, ndërhyrja për kufizimin e një të drejte ose lirie duhet të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

76. Në të njëjtën linjë, edhe GJEDNJ-ja ka theksuar nevojën për të peshuar interesat e ndryshme në lojë, duke vlerësuar nevojën për të bllokuar të gjithë aksesin në faqe të caktuara. Një

masë që bllokton aksesin në tërësinë e një faqeje interneti duhet të justifikohet më vete dhe në mënyrë të dallueshme nga justifikimi që qëndron në themel të urdhrit fillestar që synon përmbajtjen e paligjshme, si dhe në raport me kriteret e përcaktuara dhe të zbatuara nga Gjykata (GJEDNJ-ja) sipas nenit 10 të KEDNJ-së (*shih Ahmet Yıldırım kundër Turqisë, datë 18.12.2012, § 66*). Ajo ka vënë në dukje se autoritetet duhet të kishin marrë në konsideratë, ndër aspekte të tjera, faktin se një masë e tillë, duke i bërë sasi të mëdha informacioni të paarrtshme, do të kufizonte ndjeshëm të drejtat e përdoruesve të internetit dhe do të kishte një efekt anësor të konsiderueshëm (*shih Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 01.12.2015, § 64*). Po ashtu, ajo ka theksuar se fakti që aplikantët mund të vazhdojnë të publikojnë në platforma të tjera nuk përbën “zëvendësim ekuivalent për faqet e tyre kryesore dhe të plota të lajmeve” të bllokuara nga autoritetet lokale. Edhe fakti që bllokimi i faqes së internetit mund të anashkalohej përmes VPN-ve dhe shërbimeve të tjera të palëve të treta nuk mund ta “zbutë” ndikimin e urdhrave të tillë (*shih RFE/RL Inc. dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit, datë 13.06.2024, §§ 72-73*). GJEDNJ-ja ka konstatuar në disa raste se një urdhër bllokimi masiv kundër një faqeje interneti është një masë ekstreme, e cila është krahasuar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe organe të tjera ndërkombëtare me ndalimin e një gazete ose transmetuesi (*shih OOO Flavus dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 23.06.2020, § 37; Bulgakov kundër Rusisë, datë 23.06.2020, § 34*).

77. Për vlerësimin e proporcionalitetit, Gjykata ka elaboruar disa nënkritere dhe konkretisht: (i) nëse objektivi i ligjvënësimit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, pra se ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra sesa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, pasi, sa më të mëdha të jenë efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t’u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

78. Në referim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata vëren se, sikurse u përmend në analizën e kriterit të interesit publik, objektivat e subjektit të interesuar lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijëve nga përmbajtje potencialisht të dëmshme që mund të shpërndahen në platformën “TikTok”. Këto objektiva lidhen drejtpërdrejt me detyrimin pozitiv të shtetit, sipas nenit 54 të Kushtetutës, për të garantuar mjedise të sigurta

për të miturit dhe për të ndërmarrë masa parandaluese kur ekziston rrezik real për zhvillimin e tyre fizik, psikologjik apo moral. Në këtë drejtim, mbrojtja e të miturve përbën një interes publik me peshë të veçantë në një shoqëri demokratike dhe është njohur si një nga qëllimet legjitime që mund të justifikojë kufizime të caktuara në ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore. Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë edhe statistikën dhe provat e paraqitura gjatë gjykimit kushtetues mbi ndikimin e mundshëm të përmbajtjeve të caktuara në platformat digjitale ndaj të miturve, Gjykata çmon se objektivi i synuar nga autoritetet publike është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar, në parim, vendosjen e një kufizimi ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit. Megjithatë, vetë rëndësia e objektivit nuk mjafton për të justifikuar çdo lloj mase kufizuese, pasi autoriteti publik mbetet i detyruar të zgjedhë atë mjet që cenon sa më pak të jetë e mundur ushtrimin e të drejtave themelore, duke shmangur atë që, sipas mendimit të Avokatit të Popullit, mund të konsiderohet si një formë e censurës moderne, në kundërshtim me standardet demokratike dhe detyrimet ndërkombëtare për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

79. Në lidhje me nënkriterin e lidhjes së arsyeshme ndërmjet masës dhe objektivit të synuar, Gjykata vëren se ndalimi i aksesit në platformën “TikTok” ka prodhuar efekte të drejtpërdrejta për të gjithë përdoruesit e saj, përfshirë median dhe gazetarët që e përdorin atë si mjet për shpërndarjen e informacionit të publiku. Për shkak të natyrës së saj gjithëpërfshirëse, kjo masë nuk ka synuar vetëm grupin që kërkohej të mbrohej, por ka prekur të gjithë përdoruesit e platformës, pa dallim midis të miturve dhe të rriturve, përdoruesve aktualë dhe potencialë, si edhe subjektet mediatike që e përdornin platformën si kanal të komunikimit publik. Në këto kushte, ndonëse qëllimi i ndjekur është legjitim dhe me peshë të veçantë kushtetuese, Gjykata çmon se mënyra e zgjedhur për realizimin e tij paraqet një shkallë shumë të lartë intensiteti në raport me shtrirjen e përgjithshme të masës.

80. Për këtë aspekt, subjekti i interesuar në seancën plenare u shpreh se nuk kishte mjete teknike në dispozicion për të arritur qëllimin e synuar, pasi, për sa kohë aplikacioni është në pronësi të një subjekti privat, Këshilli i Ministrave nuk mund të ndërhynte drejtpërdrejt në krijimin, përmbajtjen apo strukturën e tij. Megjithatë, Gjykata vëren se, si nga parashtrimet e kërkueseve, ashtu edhe nga materiali shpjegues i administruar nga subjekti i interesuar, rezultojnë masa alternative si verifikimi i moshës, kontrolli prindëror, filtrat e moderimit në gjuhën shqipe, bashkëpunimi me platformën dhe masa të tjera që synojnë mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e

dëmshme, të cilat janë potencialisht më pak kufizuese se bllokimi i përgjithshëm i platformës. Në këto kushte, ndonëse mungesa e mundësisë teknike të drejtpërdrejtë për të ndërhyrë në funksionimin e platformës përbën një rrethanë relevante në vlerësimin e proporcionalitetit, Gjykata çmon se ajo nuk mjafton si e tillë për të justifikuar domosdoshmërinë e bllokimit të përgjithshëm të aksesit, për sa kohë duhej vlerësuar nëse ekzistonin mjete të tjera juridike, rregullatore ose bashkëpunuese, potencialisht më pak kufizuese, për arritjen e objektivit të synuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se subjekti i interesuar nuk ka shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme mundësinë e përdorimit të këtyre mjeteve, duke mos provuar në mënyrë bindëse se një bllokim i përgjithshëm i platformës përbënte mjetin e vetëm efektiv dhe të domosdoshëm për arritjen e objektivit të synuar.

81. Po kështu, për sa i përket nënkriterit të tretë, nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, Gjykata vëren se, ndonëse kategoria e gazetarëve dhe subjektet mediatike, gjatë kohës së bllokimit të platformës “TikTok”, kanë pasur në dispozicion edhe mjete të tjera komunikimi që ishin funksionale, vetë ekzistenca e tyre nuk mund të jetë element vendimtar për proporcionalitetin e një mase që eliminon tërësisht aksesin në një hapësirë të caktuar komunikimi publik. Po ashtu, edhe sipas standardeve të përmendura më sipër, ekzistenca formale e kanaleve të tjera të komunikimit nuk përbën, në vetvete, një zëvendësim ekuivalent, nëse ato nuk ofrojnë në praktikë të njëjtën mundësi për të arritur audiencën, veçanërisht publikun e ri, dhe për të ushtruar të njëjtin ndikim në debatin publik. Në këtë kuptim, fakti që përdoruesit apo mediat mund të kenë akses në platforma të tjera nuk është i mjaftueshëm për ta bërë ndërhyrjen proporcionale.

82. Gjithashtu, Gjykata merr në konsideratë edhe faktin se masa e parashikuar ka pasur një afat të përcaktuar prej 12 muajsh, por njëkohësisht është lidhur edhe me kushtin që ofruesi i platformës të mundësonte instrumente teknike për rregullimin e aksesit të fëmijëve në këtë platformë dhe të përmbajtjeve të dëmshme për ta. Subjekti i interesuar në seancën plenare publike pranoi se përfaqësuesit e platformës “TikTok” janë shprehur të gatshëm për negociata dhe se periudha e mbylljes do të përdorej për të bashkëpunuar për plotësimin e kushteve të nevojshme, në mënyrë që përdorimi i platformës të përputhej me standardet e kërkuara. Gjykata vëren se një fakt i tillë tregon se ekzistonte, të paktën në parim, hapësirë për masa bashkëpunuese dhe më pak kufizuese se sa bllokimi i përgjithshëm dhe i menjëhershëm i platformës. Në këto kushte, fakti që

masa ishte e përkohshme nuk mjafton për ta bërë atë proporcionale, për sa kohë ajo mori formën e një ndalimi të përgjithshëm dhe u lidh me një kusht të ardhshëm e të pasigurt, që varej nga zhvillimet teknike të vetë platformës. Po ashtu, Gjykata vëren se VKM-ja nr. 151/2025 nuk ka parashikuar një periudhë kalimtare për hyrjen në fuqi të masës, as nuk u ka dhënë subjekteve të prekura, përfshirë median dhe gazetarët që e përdornin platformën si kanal komunikimi me audiencën, kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur me situatën e re dhe për të organizuar mjete alternative komunikimi, çka e ka rritur intensitetin e ndërhyrjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se intensiteti i ndërhyrjes nuk ka qenë në raport të arsyeshëm me rëndësinë e objektivit të mbrojtjes së të miturve.

83. Gjykata vëren gjithashtu se subjekti i interesuar ka sjellë në vëmendje edhe zhvillimin e një konsultimi të gjerë me prindërit, të mbështetur edhe nga të dhëna statistikore. Ndonëse, nga këndvështrimi i interesit publik që ka synuar masa, një praktikë e tillë vlerësohet si pozitive dhe në përputhje me parimet e një procesi vendimmarrës gjithëpërfshirës, ajo nuk mjafton, në vetvete, për ta bërë ndërhyrjen proporcionale. Kjo sepse masa, ndonëse synon mbrojtjen e një interesi kushtetues, përkatësisht mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, ndërhyr njëherazi dhe në mënyrë intensive në ushtrimin e një interesi tjetër kushtetues, atë të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit. Për këtë arsye, Gjykata çmon se, në situata të tilla, konsultimi duhet të zhvillohet në mënyrë të balancuar dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë jo vetëm grupet që synohet të mbrohen nga masa, por edhe subjektet që preken drejtpërdrejt prej saj.

84. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, pasi mjeti i zgjedhur nga autoritetet publike ka qenë më i ashpër se sa kërkohej për arritjen e objektivit të synuar dhe nuk rezulton të jetë provuar se bllokimi i përgjithshëm i platformës përbënte mjetin e vetëm efektiv dhe të domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijëve.

85. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueseve për cenimin e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa në këtë pjesë pranohet.

86. Gjykata çmon se, në kushtet kur VKM-ja nr. 151/2025 nuk është më pjesë e rendit juridik, për shkak të shfuqizimit të saj me VKM-në nr. 62/2026, kërkimi i kërkueseve për shfuqizimin e saj ka mbetur pa objekt. Në këto kushte, duke mbajtur parasysh se Gjykata, në

përputhje me nenin 51, pika 2, të Ligjit Organik të saj, vlerësoi se çështja paraqet interes publik dhe vijoi shqyrtimin në themel, ajo çmon se duhet të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit si pasojë e zbatimit të VKM-së nr. 151/2025, me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave themelore dhe sqarimin e standardeve kushtetuese për raste të ngjashme në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, si dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit si rezultat i zbatimit të VKM-së nr. 151/2025.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.03.2026

Shpallur më 22.04.2026

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që u përket kërkueseve shoqata “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë” dhe Qendra “Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative, Shqipëri – Balkan Investigative Reporting Network, Albania”, me objekt “*Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line “TikTok”*”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e

Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line “TikTok””, unë, gjyqtari Sandër Beci, jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Për këtë shkak parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Kërkuueset kanë pretenduar se VKM-ja e cila ka parashikuar ndërprerjen e aksesit në platformën *on-line* “TikTok” në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat deri në 12 muaj, ka cenuar të drejta dhe liri kushtetuese, të cilat shumica ka vlerësuar t’i analizojë në drejtim të lirisë së shprehjes dhe të shtypit. Sipas saj, ndërprerja e përgjithshme në platformën “TikTok” përbën ndërhyrje në ushtrimin e të këtyre lirive dhe për këtë arsye ka vlerësuar të analizojë faktin nëse kjo ndërhyrje ka qenë e justifikuar, pra nëse është bërë me ligj, nëse ka ndjekur një interes publik ose një qëllim të ligjshëm dhe nëse ka qenë proporcionale në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Shumica ka vlerësuar se dispozitat ligjore, mbi bazën e të cilave është miratuar VKM-ja, nuk i japin Këshillit të Ministrave një autorizim të qartë, të posaçëm dhe të parashikueshëm për vendosjen e një mase me karakter të përgjithshëm, siç është ndërprerja e plotë e aksesit në një platformë *on-line* për të gjithë përdoruesit. Në këtë mënyrë, sipas shumicës, nuk është respektuar kriteri i kufizimit “vetëm me ligj”, sipas nenit 17 të Kushtetutës, në lidhje edhe me nenin 118 të saj, pasi VKM-ja nuk mund të konsiderohet thjesht si akt që detajon teknikisht një kufizim të parashikuar më parë nga ligji, por si akt që ka materializuar vetë kufizimin në elementet e tij thelbësore. Ndërsa për sa i përket kriterit të dytë, për interes publik, shumica ka vlerësuar se ai përmbushet për sa kohë konsiston në mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të mirë të fëmijëve, si dhe në mbrojtjen e të rinjve (*shih paragrafët 54, 57, 65, 67 dhe 72 të vendimit*).

3. Lidhur me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, shumica ka evidentuar tre nënkriteret e tij, duke vlerësuar se (i) objektivi i synuar nga autoritetet publike është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar, në parim, vendosjen e një kufizimi ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit; (ii) subjekti i interesuar nuk ka shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme mundësinë e përdorimit të mjeteve potencialisht më pak kufizuese, duke mos provuar në mënyrë bindëse se një bllokim i përgjithshëm i platformës përbënte mjetin e vetëm efektiv dhe të domosdoshëm për arritjen e objektivit të synuar, (iii) intensiteti i ndërhyrjes nuk ka qenë në një raport të arsyeshëm me rëndësinë e objektivit të mbrojtjes të të miturve, prandaj ndërhyrja nuk

përmbush kriterin e proporcionalitetit të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se pretendimet janë të bazuara, ndaj ka vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit (*shih paragrafët 78, 80, 81, 84 dhe 86 të vendimit*).

4. Ndërsa pajtohem me analizën e shumicës lidhur me *kriterin për interes publik*, për sa kohë vlerësoj se VKM-ja e kundërshtuar ka pasur si qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të mirë të fëmijës dhe të të rinjve, duke minimizuar rastet e dhunës dhe bullizmit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien emocionale ose sociale të tyre, nuk ndaj të njëjtin qëndrim për sa u përket dy kritereve të tjera të kufizimit të lirive, ndaj në vijim do të paraqes argumentet për secilin prej tyre.

5. *Së pari*, lidhur me *kriterin “vetëm me ligj”*, sikurse ka evidentuar shumica, VKM-ja e kundërshtuar ka dalë në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit për komunikimet elektronike, ligjit për mediat audiovizive dhe ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në mendimin tim, këto akte ligjore, të marra së bashku, përbëjnë bazë të mjaftueshme ligjore për nxjerrjen e VKM-së nr. 151/2025. Kështu p.sh. nenet 26, pika 1, dhe 139, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 54/2024 (për komunikimet elektronike) parashikojnë se kufizimet në fushën e komunikimeve elektronike mund të vendosen për arsye të interesit publik, sigurisë publike ose shëndetit publik, me kusht që ato të jenë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të respektojnë të drejtat themelore dhe të përmbushin kërkesat e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë. Nga ana tjetër, neni 27, pikat 3 dhe 4, i ligjit nr. 18/2017 (për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës) parashikon shprehimisht marrjen e masave për bllokimin e aksesit në rastin e materialeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, duke ia lënë konkretizimin e këtyre masave vendimit të Këshillit të Ministrave.

6. Nisur nga kjo, vlerësoj se edhe pse kuadri ligjor nuk parashikon në mënyrë shteruese çdo modalitet të mundshëm ndërhyrjeje në mjedisin digjital, ai përcakton në mënyrë të mjaftueshme bazën, qëllimin dhe drejtimin e ndërhyrjes shtetërore në funksion të mbrojtjes të të miturve dhe të interesit publik. Në këtë kuptim, akti nënligjor objekt shqyrtimi ka shërbyer për konkretizimin e një mase të parashikuar në ligj, brenda kufijve të rezervës ligjore relative të lejuar nga neni 118 i Kushtetutës, dhe jo për krijimin *ex novo* të një kufizimi të paparashikuar nga ligjvënësi. Në këto kushte, çmoj se është respektuar kriteri i kufizimit “vetëm me ligj”, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

7. *Së dyti*, lidhur me kriterin tjetër, atë të *proporcionalitetit të ndërhyrjes*, çmoj se në drejtim të nënkriterit të parë (*nëse objektivi i ligjvënësisë është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës*), duke marrë në konsideratë edhe statistikën dhe provat e paraqitura gjatë gjykimit kushtetues për ndikimin e mundshëm të përmbajtjeve të caktuara në platformat digjitale ndaj të miturve, objekti i ligjvënësisë konsiderohet i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit të kërkueseve në një masë të mjaftueshme.

8. Për sa i përket nënkriterit tjetër (*nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, pra se ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësimet alogjike*), ndonëse kjo masë (ndalimi i aksesit në platformën TikTok) nuk i është drejtuar vetëm grupit që synohet të mbrohet (pra fëmijëve dhe të rinjve), por ka prekur të gjithë përdoruesit e platformës, ajo nuk mund të konsiderohet arbitrare për sa kohë që subjekti i interesuar nuk mund të ndërhynte drejtpërdrejt në përmbajtjet *online* të vetë platformës. Kjo për shkak se natyra e mjedisit digjital dhe mënyra e funksionimit të platformave globale *online* bëjnë të vështirë ndërhyrjen selektive vetëm mbi një kategori të caktuar përdoruesish, sidomos kur këto platforma operojnë jashtë juridiksionit të drejtpërdrejtë të autoriteteve kombëtare.

9. Në këtë kuptim, masa e përgjithshme paraqitet si një mjet i domosdoshëm për të arritur objektivin mbrojtës. Nëse objektivi i ligjvënësisë është mbrojtja e një grupi vulnerabël, sikurse janë fëmijët dhe të rinjtë, atëherë masa duhet të jetë e tillë që realisht të parandalojë ekspozimin ndaj rreziqeve përkatëse. Një ndërhyrje e pjesshme ose selektive, në kushtet e mungesës së mekanizmave teknikë dhe juridikë për filtrimin efektiv të përmbajtjes, do të ishte potencialisht iluzore dhe, për rrjedhojë, jo e përshtatshme për arritjen e qëllimit.

10. Po kështu duhet theksuar edhe fakti se masa ndaluese ka karakter të përkohshëm (në fakt gjatë gjykimit u soll në vëmendje të Gjykatës së VKM-ja ishte shfuqizuar), është e rishikueshme dhe e justifikuar nga rrethanat konkrete që lidhen me mbrojtjen e interesit publik. Ndalimi i aksesit për një periudhë 12-mujore tregon se nuk kemi të bëjmë me një ndërhyrje të përhershme ose të pakthyeshme, por me një masë të kufizuar në kohë, e cila synon të adresojë një situatë konkrete dhe të rishqyrtohet në vijimësi. Kjo përkohshmëri e bën ndërhyrjen më të përshtatshme në raport me qëllimin e ndjekur. Për rrjedhojë, VKM-ja nr. 151/2025, përmbush këtë nënkriter të proporcionalitetit.

11. Po kështu, edhe nënkriterin e tretë (*nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra sesa duhet për të arritur objektivin e kërkuar*) e konsideroj të përmbushur, pasi kufizimi i vendosur nuk ka sjellë një ndalim absolut të ushtrimit të lirisë së shprehjes ose të shtypit, por vetëm një kufizim të një kanali specifik përmes të cilit kjo e drejtë ushtrohet. Kërkueset kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë në dispozicion një gamë të gjerë mjetesh alternative, si platforma të tjera digjitale, media tradicionale ose forma të tjera komunikimi publik, të cilat u mundësojnë të shpërndajnë informacion dhe të shprehin qëndrimet e tyre. Në këtë kuptim, masa nuk cenon thelbin e së drejtës, por vetëm një nga mënyrat e ushtrimit të saj.

12. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë interesin publik që synohet të mbrohet, konkretisht mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga përmbajtje potencialisht të dëmshme, një kufizim i përkohshëm dhe i fokusuar mbi një platformë të vetme nuk mund të konsiderohet si masë e tepruar, për sa kohë që nuk ekzistojnë mjete të tjera më pak kufizuese që të jenë njëkohësisht efektive. Gjithashtu, vlen të përmendet se masa nuk shoqërohet me sanksione individuale ndaj përdoruesve, as nuk ndërhyr në përmbajtje të caktuara në mënyrë selektive, por vepron në mënyrë të përgjithshme, çka tregon se mjete të zgjedhur, megjithëse i përgjithshëm, nuk është më i ashpër sesa kërkohet nga rrethanat.

13. Për sa më lart, duke pasur parasysh ekzistencën e alternativave për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të pretenduara të cenuara nga kërkueset, karakterin e përkohshëm të masës, si dhe rëndësinë e interesit publik që synohet të mbrohet, vlerësoj se ndërhyrja përmbush kriterin e proporcionalitetit të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës.

14. Në përfundim, çmoj se pretendimi i kërkueseve për cenimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit është i pabazuar, prandaj duhet të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtar: Sandër Beci